



Republika e Kosovës

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti shërbimeve këshillimore teknike
Department of Technical and Advisory Services
Departmend za tehničke i savjetodavne usluge



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova

Spërkatja Dimërore dhe Gëlqerosja e Pemëve Frutore

Spërkatja Dimërore

Spërkatja dimërore e pemëve është masë e rëndësishme agroteknike me anë të së cilës eliminohet një numër i madh i shkaktarëve të sëmundjeve dhe dëmtuesve, Spërkatja dimërore eliminon dëmtuesit nga viti paraprak dhe është masa më e rëndësishme preventive që ndikon në zvogëlimin e intensitetit të dëmtuesve dhe sëmundjeve të ndryshme.

Para se të fillohet me spërkatje, më parë është mirë të kryhet krasitja e pemëve, të eliminohen degët e thyera dhe të infektuara, të eliminohen frutat e mbetur, etj. Me spërkatje dimërore ndikohet në mënyrë preventive, ku bëhet eliminimi dhe zvogëlimi i infeksioneve, nga shkaktarë të ndryshëm të sëmundjeve dhe dëmtuesve. Spërkatja duhet të kryhet në mot të mirë, pa erë dhe në temperaturë mbi 10°C.

Të gjitha pemët frutore janë të ndjeshme ndaj insekteve dhe sëmundjeve që ndikojnë në cilësinë e frutave dhe shëndetin e pemëve. Periudha e fjetjes-qetësis dimërore, e cila fillon pas rënies së gjetheve, është koha ideale për të ndërmarrë masa mbrojtëse.

Për këtë arsye, është thelbësore që pemët të trajtohen **me kujdes** dhe të mbulohen nga të gjitha anët me sasi të mjaftueshme të preparatit, duke u siguruar që tretësira të depërtojë në të gjitha degëzat.

Spërkatja dimërore ndihmon në parandalimin e sëmundjeve të zakonshme si përdredhja e gjetheve të pjeshka, deformimi i frutave të kumbulla, kroma e mollës, hiri, djegia bakteriale e mollës dhe bërthamoreve, monilia dhe sëmundje të tjera që ndikojnë në

cilësinë dhe prodhimin e frutave. Njëkohësisht, ky trajtim eliminon edhe një numër të madh insektesh të dëmshme si morrat e gjethit, gjethepërgjakësin e mollës, lulëngrënësin dhe merimangën e kuqe, të cilët mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme në pemishte.

Për ata fermerë që ende nuk e kanë kryer spërkatjen dimërore, rekomandohet përdorimi i preparateve specifike për këtë trajtim. Një nga produktet kryesore është Vaji i Kuq, i cili përbëhet nga vaj mineral me shtesë bakri dhe siguron një mbrojtje efektive kundër insekteve sëmundjeve dhe marimangave. Gjatë aplikimit të tij, është e rëndësishme të sigurohet cilësi e lartë e trajtimit, duke përgatitur tretësirën me kujdes dhe duke e aplikuar në mënyrë të njëtrajtshme. Një tjetër opsion është përdorimi i insekticideve dimërore, si p.sh. Galmini, i cili, për një efekt më të mirë, mund të kombinohet me preparate bakri.

Duke marrë këto masa në kohën e duhur, pemishtet tuaja do të jenë më të mbrojtura dhe do të përgatisin një bazë të shëndetshme për sezonin e ardhshëm të prodhimit.



Gëlqerosja - Cila është rëndësia dhe çfarë shërben gëlqerosja e pemëve?

Gëlqerosja e pemëve ndihmon në vonimin e lëngjeve dhe nisjes së vegetacionit të hershëm, duke parandaluar kështu dëmet nga ngricat e mundshme në pranverë. Gjithashtu, ajo mund të mbrojë pemët nga insektet dhe sëmundjet që zhvillohen gjatë dimrit, si rezultat i vezëve të parazitëve të vendosura në lëvoren e tyre. Për më tepër, gëlqerosja ka një efekt mbrojtës edhe ndaj brejtësve dhe kafshëve të tjera që mund të dëmtojnë pemët. Një numër i madh i insekteve dhe patogjenëve dimërojnë pikërisht në lëvoren e pemëve, prandaj lyerja me gëlqere ndihmon në shkatërrimin e tyre ose e pamundëson daljen e tyre në pranverë.

Për ata që ende nuk i kanë gëlqerosur pemët dhe dëshirojnë ta bëjnë, më poshtë është një recetë e thjeshtë:

Përgatitja

- 5 kg gëlqere e shuar
- 500 gr kripë
- 250 gr squfur për tretje
- 15-20 litra ujë

Kjo sasi përzihet mirë derisa të krijohet një masë e trashë, e përshtatshme për aplikim me furça mbi lëvoren e pemëve. Ky trajtim do të ndihmojë në mbrojtjen e pemëve, duke siguruar një fillim të shëndetshëm të sezonit të ri vegjetativ.

Për çdo këshillë apo sqarim lidhur me spërkatjen dimërore, si dhe këshilla të tjera mbi bujqësinë dhe zhvillimin rural, mund të drejtoheni te këshilltarët e QIKK (Qendrat Këshilluese Informative Komunale). Gjithashtu, në QIKK mund të furnizoheni me materiale të shtypura që mund t'ju ndihmojnë në përmbushjen e nevojave tuaja bujqësore.